

Spar ALBANIA Sh.p.k.

**Pasqyrat Financiare
për vitin ushtrimor të mbyllur
më 31 dhjetor 2017**

Permbajtja

	Faqe
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR.....	0
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL.....	3
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË.....	4
1. INFORMACION I PERGJITHSHËM.....	5
2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL.....	5
2.1 Deklarata e përputhshmërisë.....	5
2.2 Baza e pergatitjes.....	5
2.3 Monedha funksionale dhe raportuese.....	5
2.4 Kombinimi i bizneseve.....	5
2.5 Transaksionet në monedhë të huaj.....	5
2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM).....	6
2.5 Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim).....	6
2.6 Instrumentat financiarë.....	6
2.7 Aktivet e trupëzuara.....	6
2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM).....	7
2.7 Aktivet e trupëzuara (vazhdim).....	7
2.8 Aktivet e patrupëzuara.....	7
2.9 Inventari.....	7
2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM).....	8
2.10 Rënia në vlerë.....	8
2.11 Përfitimet e punonjësve.....	8
2.12 Provigjonet.....	8
2.13 Të ardhurat.....	8
2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM).....	9
2.13 Të ardhurat (vazhdim).....	9
2.14 Pagesat e qirasë.....	9

2.15	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare.....	9
2.16	Kostot e huamarrjes.....	9
2.17	Tatim fitimi.....	9
2.	PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)	10
2.18	Kompensimi.....	10
3.	PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE	10
3.	PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE (VAZHDIM)	11
4.	STANDARDE TË PUBLIKUARA POR ENDE JO NE FUQI	11
4.	STANDARDE TË PUBLIKUARA POR ENDE TË PAZBATUARA (VAZHDIM)	12
5.	TË ARDHURA NGA SHITJA E MALLRAVE	13
6.	TË ARDHURA TË TJERA	13
7.	KOSTO E MALLRAVE TË SHITURA	13
8.	SHPENZIME PËR MATERIALE	13
9.	SHPENZIME PËR SHËRBIME	14
10.	SHPENZIME PËR PERSONELIN	14
11.	(HUMBJA)/ FITIMI NETO NGA KURSET E KEMBIMIT	14
12.	SHPENZIME TË TJERA	15
13.	SHPENZIME FINANCIARE	15
14.	TATIMI MBI FITIMIN	15
14.	TATIMI MBI FITIMIN (VAZHDIM)	16
15.	AKTIVET TË TRUPËZUARA, NETO	17
16.	AKTIVET TË PATRUPËZUARA, NETO	18
17.	INVENSTIME MBI SHOQËRITË E KONTROLLUARA	18
18.	HUADHËNIE	18
19.	INVENTARI	19
20.	LLOGARI TË ARKËTUESHME DHE TË DREJTA TË TJERA	19
21.	MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTET TË TYRE	19
22.	KAPITALI AKSIONAR	20
23.	HUAMARRJE	20
24.	LLOGARI TË PAGUESHME DHE DETYRIME TË TJERA	21

25. PALËT E LIDHURA.....	21
25. PALËT E LIDHURA (VAZHDIM).....	22
26. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA	22
27. OBJEKTIVAT DHE POLITIKAT E MENAXHIMIT TË RISKUT FINANCIAR	22
27. OBJEKTIVAT DHE POLITIKAT E MENAXHIMIT TË RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)...	23
28. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT	24



Ernst & Young Certified Auditors
Albania Branch
NIUS: K619110121
Ibrahim Rugova Str
Sky Tower, 6th floor
1001, Tirana, Albania

Tel: +35542419575
ey.com

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtimit dhe Aksionarëve të Spar ALBANIA Sh.p.k.

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Spar ALBANIA sh.p.k. (më poshtë "Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2017, si dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithpërfshirëse, të ndryshimeve në kapital, dhe të flukseve të parasë për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017, dhe performancën e saj financiare dhe të fluksit të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin *Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare* të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me *Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël* (Kodi i "BSNEPK") së bashku me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri (Kodi IEKA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe të Kodit BSNEPK.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e SPAR Elbasan Sh.p.k përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young Ekspertë Kontabël të Autorizuar,
Dega në Shqipëri

Ernst & Young Certified Auditors

28 shtator 2018
Tiranë, Shqipëri



Mario Vangjeli
Ekspert Kontabël i Regjistruar

Mario Vangjeli

**PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA
GJITHPËRFSHIRËSE**

Për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2017

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga shitja e mallrave	5	5.253.421	3.402.438
Të ardhura të tjera operative	6	69.770	93.700
Totali i të ardhurave		5.323.191	3.496.138
Kosto e shitjeve	7	(3.912.379)	(2.966.873)
Shpenzime për materiale	8	(27.001)	(22.816)
Shpenzime për sherbime	9	(568.070)	(559.621)
Shpenzime për personelin	10	(209.413)	(202.411)
Shpenzime të tjera	12	(36.676)	(30.959)
Amortizime dhe zhvlerësime	15,16	(41.306)	(38.131)
Fitimi neto i këmbimeve valutore	11	(13.108)	43.309
Totali i shpenzimeve		(4.807.952)	(3.777.501)
Shpenzime financiare, neto	13	(4.360)	(24.576)
Fitimi/(humbja) para tatimit		510.879	(305.939)
Tatim fitimi (Detyrime)/aktive tatimore të shtyra	14	- (2.025)	- 1.494
Fitimi/(humbja) neto për vitin		508.854	(304.445)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave/(humbjeve) gjithpërfshirëse për vitin		508.854	(304.445)

Shënimet shoqëruese mbi pasqyrat financiare nga 1 në 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Spar ALBANIA Sh.p.k.

(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
Më 31 dhjetor 2017**

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Aktivët			
Aktivët afatgjata			
Aktive të trupëzuara, neto	15	246.803	222.888
Aktive të patrupëzuara, neto	16	1.390	3.745
Investime në shoqëri të kontrolluara	17	17.220	-
Huadhënie afatgjata	18	-	322.082
Totali i aktiveve afatgjata		265.414	548.715
Aktivët afatshkurtra			
Inventari	19	1.315.153	1.811.977
Llogari të arkëtueshme dhe të drejta të tjera	20	740.227	796.566
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	25	822.358	15.258
Huadhënie afatshkurtra	18	344.818	6.095
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	21	218.170	162.631
Aktive tatimore të shtyra		-	2.871
Totali i aktiveve afatshkurtra		3.440.726	2.795.398
Totali i aktiveve		3.706.140	3.344.113
Kapitali dhe Detyrimet			
Kapitali			
Kapitali aksionar	22	600.503	600.503
Fitimi i mbartur		999.013	490.160
Totali i kapitaleve të veta		1.599.516	1.090.662
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huamarrje afatgjata	23	110.392	104.574
Detyrime tatimore të shtyra		4.897	-
Totali i detyrimeve afatgjata		115.289	104.574
Detyrimet afatshkurtra			
Huamarrje afatshkurtra	23	357.652	351.695
Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera	24	1.633.683	1.797.181
Totali i Detyrimeve afatshkurtra		1.991.334	2.148.876
Totali i detyrimeve		2.106.623	2.253.450
Totali i detyrimeve dhe kapitaleve të veta		3.706.140	3.344.113

Këto pasqyra financiare, dhe shënimet shpjeguese nga 1 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare, janë autorizuar nga drejtimi më 10 Shtator 2018 dhe nënshkruar në emër të tij nga:

Elona Mema
Administratore





Dorian Memo
Drejtore Finance



PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL
Për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2017

	<u>Kapitali themeltar</u>	<u>Fitimi /(humbja) i/e mbartur</u>	<u>Totali i kapitalit</u>
Gjëndja më 1 janar 2016	79.786	(375.480)	(295.694)
Rritja e kapitalit aksionar	500.000	-	500.000
Shtesa nga përthithja e RFZ Building	20.717	1.170.084	1.190.801
Totali	<u>600.503</u>	<u>794.604</u>	<u>1.395.107</u>
Humbja e periudhës	-	(305.939)	(305.939)
Të ardhura te tjera gjithpërfshirëse	-	1.494	1.494
Totali i humbjeve gjithpërfshirëse për vitin	<u>-</u>	<u>(304.445)</u>	<u>(304.445)</u>
Gjëndja më 31 dhjetor 2016	<u>600.503</u>	<u>490.160</u>	<u>1.090.662</u>
Fitimi i periudhës	-	510.879	510.879
Të ardhura/(humbje) të tjera gjithpërfshirëse	-	(2.025)	(2.025)
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin	<u>-</u>	<u>508.854</u>	<u>508.854</u>
Gjëndja më 31 dhjetor 2017	<u>600.503</u>	<u>999.013</u>	<u>1.599.516</u>

Shënimet shoqëruese mbi pasqyrat financiare nga 1 në 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Spar ALBANIA Sh.p.k.

(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË
Për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2017

Shenime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Flukset e parasë nga veprimtaritë shfrytëzuese		
Fitimi (humbja) para tatimit	510.879	(305.939)
<i>Rregullime për:</i>		
Amortizimi dhe zhvlerësimi	15,16 41.306	38.131
Provizjoni	(2.615)	-
Fitimi nga shitja e aktiveve të trupëzuara	-	(3.191)
Shpenzime interesi, bruto	4.360	24.576
<i>Ndryshimet në kapitalin qarkullues:</i>		
Ndryshimi në llogaritë e arkëtueshme	(749.915)	266.198
Ndryshimi në inventarë	499.438	73.740
Ndryshimi në llogaritë e pagueshme	(158.601)	(230.339)
Interesi i paguar	(4.360)	(24.576)
Flukset e gjeneruara nga veprimtaritë e shfrytëzimit	140.492	(161.399)
Flukset e parasë nga veprimtaritë investuese		
Investime në aksione për Spar Elbasan	17 (17.220)	-
Rritje nga perthithja e RFZ Building	-	112.061
Blerja a aktiveve afatgjata të trupëzuara	15 (63.801)	(39.600)
Arkëtime nga shitja e aktiveve të trupëzuara	15 934	10.141
Flukset e përdorura për veprimtaritë investuese	(80.087)	82.602
Flukset e parasë nga veprimtaritë financuese		
Rritje e kapitalit	22 -	500.000
Pagesa huamarrie	23 (4.866)	(381.037)
Flukset e përdorura në veprimtaritë financuese	(4.866)	118.963
Rritja e parasë në arkë dhe në bankë	55.540	40.166
Paraja në arkë dhe në bankë më 1 janar	162.631	122.465
Paraja dhe ekuivalentet e saj më 31 dhjetor	218.170	162.631

Shënimet shoqëruese mbi pasqyrat financiare nga 1 në 24 janë pjesë përberëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. INFORMACION I PERGJITHSHËM

Shoqëria Spar ALBANIA Sh.p.k. është krijuar më datë 1 prill 2015 dhe është regjistruar në regjistrin e shoqërive tregtare në të njëjtën ditë, me kapital të nënshkruar 100 lekë. Gjatë 2015 kapitali i shoqërisë u rrit në 79.786.400 lekë. Kapitali i shoqërisë zotërohet nga ortakët i vetëm Balfin Group sh.p.k., zotërues i 100% të kuotave.

Gjatë vitit 2017, Shoqëria investoi në aksione për themelimin e një shoqërie të re Spar Elbasan Sh.p.k me një vlerë investimi prej 17.220.150 lekë që përbën 51% të aksioneve të Shoqërisë.

Në vitin 2016, Shoqëria e rriti kapitalin e saj me 500 milion leke, si dhe përthithi Shoqërinë RFZ Building (dhe kjo në pronësi të Balfin Group sh.p.k.) me kapital 20.716.514 lekë. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë së përthithur RFZ Building është investimi në ndërtim.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është: tregtimi i mallrave me shumicë e pakicë, import-eksport, etj, sipas objektit të veprimtarisë të përcaktuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Administratori i shoqërisë është Znj. Elona Mema. Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017 është 451 (2016: 404).

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") të hartuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

Shoqërisë nuk i nevojitet që të paraqesë pasqyra financiare të konsoliduara nëse shoqëria mëmë përfundimtare ose e ndërmjetme e shoqërisë mëmë prodhon pasqyra financiare të konsoliduara, të cilat janë në koherencë me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar.

2.2 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të kostos historike.

Politikat kryesore kontabël paraqiten më poshtë.

2.3 Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lekun Shqiptar ("lekë"), e cila është në të njëjtën kohë edhe monedha funksionale e Shoqërisë. Me përjashtim të rasteve kur është specifikisht e shprehur, informacioni financiar i shprehur në Lekë është rumbullakosur në të njëjtën më të afërt.

2.4 Kombinimi i bizneseve

Kombinimi i bizneseve kontabilizohet duke përdorur metodën e blerjes. Kostoja e blerjes matet si shuma e të gjithë vlerës së transferuar, e cila matet me vlerën e drejtë në datën e blerjes si dhe me vlerën e çdo interesi jo-kontrollues në shoqërinë e blerë.

Një kombinim biznesi që përfshin njësi ekonomike ose biznese nën kontroll të përbashkët është një kombinim biznesi në të cilin të gjitha njësitë ekonomike ose bizneset e kombinuara në fund të fundit janë të kontrolluara nga e njëjta palë ose të njëjtat palë para dhe mbas kombinimit të biznesit dhe ky kontroll nuk është kalimtar. Në këtë rast, SNRF 3 Kombinimi i Bizneseve nuk është i zbatueshem, dhe si rrjedhojë metoda e blerjes nuk duhet zbatuar.

Gjatë një kombinimi biznesesh nën kontroll të përbashkët, Shoqëria zgjedh metodën e kontabilizimit që është me e pershtatshme në rethanat. Kontabilizimi i përthithjes së RFZ Building nga ana e Shoqërisë është kryer duke agreguar vlerat kontabel neto të dy shoqërive.

2.5 Transaksionet në monedhë të huaj

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, transaksionet në monedhë të ndryshme nga monedha funksionale (monedha të huaja) rregjistrohen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Në fund të çdo periudhe raportuese, mjetet monetare në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin e datës së raportimit. Mjetet jo monetare që mbahen me vlerë të drejtë që janë të regjistruara në monedhë të huaj, rivlerësohen në kursin e datës kur përcaktohet vlera e drejtë. Mjetet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj nuk rivlerësohen.

Diferencat që rezultojnë nga konvertimi i zërave monetarë në monedhë të huaj me kurs të ndryshëm nga ato që janë konvertuar në njohjen fillestare gjatë periudhës ose në pasqyra të mëparshme financiare, njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, në periudhën që ato krijohen. Kurset e mëposhtme janë aplikuar gjatë vitit:

*(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)****2.5 Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)**

	Kursi mesatar		Kursi në datën e raportimit	
	2017	2016	2017	2016
Lek / USD	119.05	124.14	111.10	128.17
Lek / EUR	134.13	137.37	132.95	135.23

2.6 Instrumentat financiarë

Shoqëria fillimisht i ka njohur llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat në datën e krijimit të tyre. Të gjitha aktivet e tjera financiare (duke përfshirë edhe aktivet e vlerësuar me vlerën e drejtë) njihen në datën e tregtimit, datën kur shoqëria ka lidhur një kontratë për këto instrumenta.

Shoqëria ç' regjistron një aktiv financiar në momentin kur të drejtat kontraktuale për flukset nga këto aktive skadojnë, ose transferon të gjitha të drejtat për të përfituar flukset kontraktuale të të ardhurave të aktivitetit financiar me anë të një transaksioni, i cili transferon përfitimet dhe rreziqet që lidhen me pronësinë e aktivitetit. Ndonjë interes që është mbajtur apo krijuar mbi aktivet e transferuara nga shoqëria paraqitet më vete si një e drejtë apo detyrim. Detyrimet dhe të drejtat financiare kompesohen dhe paraqiten me vlerën neto në bilanc, vetëm kur shoqëria ka të drejtën ligjore për të kompensuar vlerat dhe ka për qëllim të shlyejë këto në vlerë neto, apo të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Instrumentat financiar jo derivativë të shoqërisë përfshijnë të drejta të tregtueshme dhe të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, detyrime të tregtueshme dhe të tjera.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj përfshijnë para në arkë dhe llogaritë rrjedhëse bankare.

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit minus humbjet nga zhvlerësimi.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

Të tjera

Instrumenta të tjera financiare jo derivativë janë matur me koston e amortizueshme, duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv, duke zbritur humbjet nga zhvlerësimet.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme janë klasifikuar si kapital.

2.7 Aktivet e trupëzuara*Njohja dhe matja*

Aktivitet afatgjatë materiale, maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshijnë koston e materialeve dhe punës direkte dhe kosto të tjera që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë për sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin që i është caktuar, kostot e çmontimit dhe lëvizjes së aktiveve dhe kthimin e vendodhjes së tyre në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot e kapitalizuara të huave.

Kostot gjithashtu mund të përfshijnë zëra të transferuar nga të ardhurat të tjera përmbledhëse për fitime apo humbje të kualifikimit të flukseve të parasë të mbuluara nga blerjet në monedhë të huaj të aktiveve afatgjatë materiale. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë përbërëse e funksionimit të paisjeve përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj paisjeje.

Në momentin që një nga aktivet afatgjatë materiale përbëhet nga pjesë me jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato regjistrohen si pjesë të ndara nga njëra tjetra. Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjatë materiale percaktohen duke krahasuar arkëtimet nga shitja me vlerën kontabël neto të aktivitetit afatgjatë material dhe njihen neto në të ardhura ose humbje të tjera.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.7 Aktivet e trupëzuara (vazhdim)

Kostot në vijim

Kostot për zëvendësimin e një pjese të aktivit afatgjatë material rregjistrohen me vlerën kontabël të aktivit në rast se është e mundur që përfitimet ekonomike në periudhat e ardhshme të përfshira në të të mund të rrjedhin tek Shoqëria dhe kostoja të mund të matet me besueshmëri.

Vlera e kontabël e pjesëve të ndërruara si rrjedhojë ç'rregjistrohet. Kostoja e shërbimit ditor, të vazhdueshëm të ndërtesave dhe paisjeve rregjistrohet tek fitimet ose humbjet kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi një bazë lineare mbi jetegjatesine e vlerësuar te aktiveve. Per aktivet materiale ne progres nuk llogaritet amortizim, deri ne momentin kur aktivet jane te vlefshme per perdorim. Toka nuk amortizohet. Normat vjetore te amortizimit per klasat kryesore te aktiveve afatgjata materiale jane si me poshte:

Pershkrimi	Norma vjetore e amortizimit
Ndërtesa	5%
Makineri e Pajisje	14% -25%
Mjete transporti	20%
Pajisje informatike	25%

Nje ze i aktiveve afatgjata te trupezuara c' regjistrohet kur nxirret jashte perdorimi apo shitet ose kur nuk priten perfitime ekonomike te ardhshme nga perdorimi ose shitja. Cdo fitim ose humbje qe rrjedh nga mosnjohja (c' regjistrimi) e aktivit (llogaritur si diference mes te ardhurave nga pakesimi dhe vleres kontabel te aktivit), paraqitet ne te ardhura ose shpenzime kur aktivi c' regjistrohet.

Vlera e mbetur e aktivit, jeta e dobishme dhe metodat e amortizimit rishikohen cdo periudhe financiare, duke bere ndryshimet e nevojshme sipas rastit ne fund te cdo viti financiar.

2.8 Aktivet e patrupëzuara

Njohja dhe matja

Aktivt afatgjata te patrupezuara te perftuara vecmas njihen fillimisht me kosto. Pas njohjes fillestare, aktivet afatgjata jomateriale njihen me koston minus amortizimin e akumuluar, dhe zhvleresimin e akumuluar, nese ka.

Amortizimi

Aktivt afatgjata te patrupezuara me jete te dobishme te percaktuar amortizohen pergjate jetes se tyre te dobishme ekonomike dhe vleresohen per zhvleresim sa here qe ka nje tregues qe aktivi afagjate jomaterial mund te jete zhvleresuar. Periudha dhe metoda e amortizimit te aktiveve afatgjata jomateriale me jete te dobishme te percaktuar, rishikohet te pakten ne cdo date raportimi.

Jetegjatesia e dobishme e aktiveve afatgjata te patrupezuara vleresohet te jete e fundme.

Amortizimi llogaritet ne metode lineare pergjate jetes se dobishme ekonomike te vleresuar te aktiveve afatgjata jomateriale.

Amortizimi i aktiveve afatgjata te patrupezuara me jete te dobishme te percaktuar eshte si me poshte:

Pershkrimi	Norma vjetore e amortizimit
Programe kompjuterike	20% - 25%

2.9 Inventari

Inventari paraqitet me vlerën më të ulët mes koston dhe vlerës neto të realizueshme. Shpenzimet duke përfshirë të gjitha shpenzimet e blerjes të lidhura me blerjen, transportin, tarifën doganore dhe sigurimin e ngarkesave. Inventarët janë duke u vlerësuar në baza mesatare.

Vlera neto e realizueshme paraqet çmimin përfundimtar të shitjes për inventarët minus të gjitha koston e vlerësuar të kompletimit dhe shpenzimet e nevojshme për të bërë shitjen.

Gjendjet e inventarëve të Shoqërisë në fund të vitit ushtrimor janë vlerësuar dhe paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar me metodën e koston mesatare të ponderuar të kostove të marrjes së tyre.

Vlera neto e realizueshme i referohet vlerës neto që njësi ekonomike raportuese pret të përfitojë nga shitja e inventarit, në rrjedhën normale të biznesit.

Inventarët i nënshtrohen testit të zhvlerësimit në datën e mbylljes së pasqyrave financiare. Shuma e zhvlerësimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëhere kur ka faktorë objektive që tregojnë që inventarët janë zhvlerësuar.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.10 Rënia në vlerë

Aktivitet financiare

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna objektive që ka pësuar rënie në vlerë. Një aktiv financiar bie në vlerë nëse ka të dhëna objektive të një ngjarje që ka çuar në rënie e vlerës së tij pas momentit fillestar të njohjes së aktivitetit, dhe kjo ngjarje ka efekt negativ në vlerësimin e flukseve të ardhshme nga aktivi të cilat mund të maten me besueshmëri.

Aktivitet financiare (vazhdim)

Humbja nga rënia në vlerë e aktivitetit të vlerësuar me koston e amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme që priten të gjenerohen nga ky aktiv financiar të aktualizuara me normën fillestare efektive të interesit.

Të gjitha humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (fitim ose humbje). Një humbje nga rënia në vlerë mund të çregjistrohet nëse ka ndodhur për shkak të një ngjarjeje që ka ndodhur pasi është njohur rënia në vlerë. Për aktivitetet financiare që maten me koston të amortizuar, çregjistrimi regjistrohet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (fitim ose humbje).

Aktivitet jo financiare

Në çdo datë raportimi Shoqëria rishikon vlerën kontabël të aktiveve jo-financiare, përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra, për të përcaktuar nëse ka tregues për rënie e vlerës. Nëse ka tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit në mënyrë që të përcaktohet rënia në vlerë.

Vlera e rikuperueshme e një aktiviteti ose njësisë gjeneruese të parasë është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes. Për përcaktimin e vlerës në përdorim, skontohen rrjedhat e ardhshme të parasë duke përdorur normën e skontimit para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqeve specifike të aktivitetit.

Një humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera e mbetur e një aktiviteti apo e njësisë së tij gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse.

2.11 Përfitimet e punonjësve

Kontributet e sigurimeve shoqërore

Gjatë ecurisë normale të biznesit, Shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet shoqërore, të cilat janë të detyrueshme bazuar në legjislacion. Këto kosto të kryera në emër të Shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin e ndodhjes.

2.12 Provigjonet

Provigjoni njihet kur, si pasojë e ngjarjeve të kaluara, shoqëria ka detyrime aktuale ligjore apo konstruktive të cilat mund të vlerësohen me vërtetësi, dhe ka mundësi që të ketë nxjerrje të flukseve të ardhshme të parasë për të shlyer këtë detyrim. Provigjonet përcaktohen nga aktualizimi i flukseve të pritshme me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të parasë dhe rrezikut specifik të detyrimeve.

2.13 Të ardhurat

Të ardhurat janë flukset bruto të përfitimëve ekonomike gjatë periudhës të cilat gjenerohen përgjatë ecurisë normale të aktivitetëve të biznesit.

Të ardhurat përbëjnë vlerën e drejtë të mallrave dhe shërbimeve të shitura hequr tatimin mbi vlerën e shtuar dhe skonto. Të ardhurat njihen kur shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme, është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të rrjedhin tek njësi ekonomike, kostoja e shkaktuar ose që do të shkaktohet mund të matet në mënyrë të besueshme dhe kriteret e të ardhurave janë përmbushur. Të ardhurat njihen si më poshtë:

Shitja mallrave

Shitjet e mallrave janë të njohura kur Shoqëria i ka transferuar blerësit rreziqet e mëdha dhe përfitimet e pronësisë, përgjithësisht kur konsumatori ka marrë dorëzimin e padiskutueshëm të mallrave. E ardhura e regjistruar është shuma bruto e shitjes, duke përfshirë komisionet e pagesave me kartë krediti të pagueshme për transaksionin. Tarifat e tilla janë të përfshira në koston e shpërndarjes. Të ardhurat nga shitja e mallrave me asnjë detyrim të rëndësishëm të shërbimit njihet në ofrimin e mallit.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.13 Të ardhurat (vazhdim)

Kryerja e shërbimeve

Shitjet e shërbimeve janë të njohur në periudhën kontabël në të cilën shërbimet janë kryer, duke iu referuar fazës së përfundimit të transaksionit vlerësuar mbi bazën e shërbimit aktual të parashikuar si një pjesë e shërbimeve të përgjithshme që do të ofrohen.

Të ardhura nga interesi

Të ardhurat nga interesi përlogariten në baza kohore, duke iu referuar principalit të papaguar dhe të normës efektive të interesit.

2.14 Pagesat e qirasë

Qiratë klasifikohen si qira financiare kur kushtet e qirasë transferojnë në menyrë domethënëse të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë tek qiramarrësi. Të gjitha qiratë e tjera klasifikohen si qira operative. Pagesat e bëra për qiranë operative janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave në bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës.

2.15 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përbëhen nga të ardhurat nga interesi për fondet e investuara në depozita bankare dhe nga të ardhurat nga kursi i këmbimi.

Shpenzimet financiare përbëhen nga shpenzimet e interesit të huave, shpenzime nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare në fitim dhe humbje nga rënia në vlerë e aktiveve financiare.

Humbjet apo fitimet nga kursi i këmbimit janë paraqitur në vlerë neto.

2.16 Kostot e huamarrjes

Kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve, të cilat duan një kohë të gjatë për t'u sjellë në formë përfundimtare, në mënyrë që të përdoren apo shiten, i shtohen kostos së këtyre aktiveve, deri në momentin kur këto aktive janë gati për qëllimin e tyre për përdorim ose për shitje.

Të ardhurat nga investimet e përkohshme, për sa i përket disa huave të veçanta, të cilave ende nuk ju është paguar interesi, kjo shumë ju zbritet kostove të huamarrjes dhe nuk i kapitalizohet kostos së aktivit.

Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

2.17 Tatim fitimi

Shpenzimi i tatim fitimit përfaqëson shumën e detyrimit tatimor dhe tatimit të shtyrë.

Tatim fitimi i vitit

Tatimi aktual bazohet mbi fitimin e tatueshëm të vitit. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Tatimi aktual është shuma e pritur e tatimit të pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet si diferenca e përkohshme mes vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve në pasqyrat financiare dhe bazës së tatueshme korresponduese përdorur në llogaritjen e fitimit të tatueshëm.

Detyrimet e tatimit të shtyrë në përgjithësi llogariten për të gjitha diferencat e tatueshme të përkohshme. Aktivet e tatimit të shtyrë në përgjithësi njihen për të gjitha diferencat e zbritshme të përkohshme në masën që ekziston mundësia që fitimi i tatueshëm do të jetë i mundshëm në mënyrë që këto diferenca të zbritshme të përkohshme të mund të përdoren. Këto aktive dhe detyrime të tatimit të shtyrë nuk do të njihen në qoftë se këto diferenca rezultojnë nga njohja fillestare e aktiveve dhe detyrimeve në një transaksion që nuk prek as fitimin e tatueshëm, as fitimin kontabël.

Vlera kontabël e aktiveve dhe detyrimeve të tatimit të shtyrë rishikohet në fund të çdo periudhe raportuese dhe reduktohet në masën që nuk është më e mundur që të arrihet një fitim i tatueshëm i mjaftueshëm që të lejojë që një pjesë ose i gjithë aktivi të rikuperohet. Detyrimet dhe aktivet e tatimit të shtyrë maten me normën e tatimit që pritet të përdoret në periudhën në të cilën detyrimi ka ndodhur ose aktivi është realizuar, bazuar në normat e tatimit dhe legjislacionit fiskal që ka qenë në fuqi ose ka hyrë në fuqi në fund të periudhës së raportimit.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.18 Kompensimi

Tatim fitimi dhe tatimi i shtyrë i vitit

Tatim fitimi dhe tatimi i shtyrë i vitit njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, përveçse kur lidhen me zëra që njihen në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ose drejtpërdrejtë në kapital, rast në të cilin tatim fitimi dhe tatimi i shtyrë njihen gjithashtu në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ose drejtpërdrejtë në pasqyrën e kapitalit përkatësisht.

Shoqëria nuk neton aktivet dhe detyrimet apo të ardhurat dhe shpenzimet, vetëm përveçse kur kjo kërkohet ose lejohet nga ndonjë SNRF. Gjithashtu, Shoqëria paraqet në bazë neto fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup i ngjashëm transaksionesh si psh: fitimi dhe humbja nga kursi i këmbimit. Gjithsesi Shoqëria i paraqet veçmas fitimet dhe humbjet e tilla, nëse vlerat janë materiale.

3. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE

Pergatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyre të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.

Në veçanti, elemente të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyrat financiare janë të përshkruara në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Vlerësime dhe supozime

Supozimet kryesore në lidhje me të ardhmen dhe burime të tjera kyce të pasigurisë në vlerësimet në periudhën raportuese, që kanë një risk të madh të shkaktimit të një korigjimi material të vlerës kontabël të aktiveve dhe pasiveve në vitin e ardhshëm financiar, janë përshkruar më poshtë. Shoqëria i bazon supozimet dhe vlerësimet mbi parametrat që ka pasur në dispozicion kur janë përgatitur pasqyrat financiare.

Rrethanat ekzistuese dhe supozimet në lidhje me zhvillimet e ardhshme mund të ndryshojë për shkak të ndryshimeve të tregut ose nga rrethana që dalin jashtë kontrollit të shoqërisë. Këto ndryshime janë reflektuar në supozimet kur ato ndodhin.

Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i rëndësishëm është kërkuar për të përcaktuar vlerat e tatim fitimit të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar i tatimit është i pasigurtë. Shoqëria njuh detyrimet për çështjet e parashikuara tatimore të auditimit bazuar në vlerësimin nëse do të ketë shtesa në taksë.

Kur rezultati përfundimtar tatimor ndryshon në mënyrë të rëndësishme me shumat të cilat kanë qenë regjistruar fillimisht, diferenca të tilla do të ndikojnë në tatim fitimin aktual dhe të shtyrë dhe detyrimet në periudhën në të cilën është bërë një vlerësim i tillë. Shoqëria përcakton dispozitat, në bazë të vlerësimeve të arsyeshme, për pasojat e mundshme të kontroleve nga autoritetet tatimore të vendit në të cilën vepron.

Shuma e dispozitave të tilla është e bazuar në faktorë të ndryshëm, si përvojë e auditimeve të mëparshme tatimore dhe interpretimeve e rregullave tatimore të ndryshme nga njësite ekonomike të tatueshme dhe autoriteti përgjegjës tatimore. Dallimet e tilla të interpretimit mund të krijojnë një shumëllojshmëri të gjerë çështjesh në varësi të kushteve që mbizotërojnë në vendbanimin e kompanisë përkatëse. Shoqëria vlerëson mundësinë për një çështje gjyqësore dhe daljeve të mëvonshëm të paravë , lidhur me tatimet të largëta dhe kur nuk ka detyrim kontingjent që kanë qenë të njohur.

Asetet e tatimit të shtyrë njihen për të gjitha humbjet tatimore të papërdorura deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit humbjet mund të shfrytëzohen. Gjykimi i rëndësishëm i menaxhimi është e nevojshme për të përcaktuar shumën e aktiveve të shtyra tatimore që mund të njihen, të bazuar mbi mundësinë e kohës dhe nivelin e fitimit të tatueshëm të ardhshëm së bashku me strategjitë e ardhshme të planifikimit tatimor.

3. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE (VAZHDIM)

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Nuk ka politika të rëndësishme kontabël të adoptura nga Shoqëria të cilat kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo financiare. Vlera e drejtë është përcaktuar për qëllime të informacioneve shpjeguese të bazuara në metodat e mëposhtme. Kur janë të aplikueshme, informacione rreth supozimeve të bëra në përcaktimin e vlerës së drejtë paraqiten në shënimet specifike të aktiveve ose detyrimeve.

4. STANDARDE TË PUBLIKUARA POR ENDE JO NE FUQI

Standardet dhe interpretimet që janë lëshuar, por ende nuk janë efektive, deri në datën e lëshimit të pasqyrave financiare të Shoqërisë janë dhënë më poshtë. Shoqëria synon të miratojë këto standarde, nëse është e aplikueshme, kur ato të hyjnë në fuqi.

SNRF 15 Të Ardhurat nga Kontratat me Klientët

SNRF 15 është publikuar në maj 2014, dhe i përmirësuar në prill 2016, dhe përdorur një model me pesë hapa për kontabilizimin e të ardhurave që rezultojnë nga kontratat me konsumatorët:

- identifikimi i kontratës me një klient
- identifikimi i detyrimeve të performancës në kontratë
- përcaktimi i çmimit të transaksionit
- shpërndarja e çmimit të transaksionit ndaj detyrimeve të performancës në kontratë, dhe
- njohja e të ardhurave kur (ose si) njësia ekonomike përmbush një detyrim të performances

Sipas SNRF 15, parimi bazë është që një njësi ekonomike do të njohë të ardhurat në një shumë që reflekton shumën në të cilën njësia ekonomike pret të ketë të drejtë në këmbim të transferimit të mallrave ose shërbimeve për një klient.

Ndryshimet kryesore nga praktika aktuale:

- Cdo mall apo shërbim i premtuar, i cili është i dallueshëm, duhet të njihet më vete, dhe cdo zbritje mbi çmimin e kontratës, në përgjithësi duhet të shpërndahet mbi elementet e vecantë.
- E ardhura mund të njihet më heret sesa sipas standarteve aktuale nëse vlerësimi ndryshon për ndonjë arsye (sic mund të jenë incentivat, ulje të tjera, tarifave të performancës, honoraret, suksesi i një rezultati etj) – shumata minimale duhet të njihet nëse ato nuk përbëjnë një risk të rëndësishëm kthimi.
- Momenti në të cilin e ardhura është e mundur të njihet mund të zhvendoset: disa të ardhura të cilat aktualisht janë njohur në momentin e përfundimit të kontratës, mund të duhen të njihen gjatë kohëzgjatjes së kontratës ose e kundërta.
- Ka rregulla specifike mbi licensat, garancitë, tarifave fillestare të parimbursueshme dhe marrëveshjet e ndërmjetësimit, sa për të përmendur disa.
- Si për cdo standart të ri, ka nivel të zgjeruar të shënimeve shpjeguese.

Standarti i ri i të ardhurave do të zëvendësojë të gjitha kërkesat aktuale të njohjes së të ardhurave sipas SNRF. Aplikimi është efektiv për periudhat më ose pas 1 janar 2018 dhe metodat e aplikimit janë ose aplikim i plotë i periudhave të mëparshme ose aplikim i modifikuar i periudhave të mëparshme. Aplikimi i më hershëm është i lejuar. Shoqëria planifikon të aplikojë standartin e ri në datën e kërkuar efektive duke përdorur metodën e modifikuar të periudhave të mëparshme, që do të thotë se efekti i akumuluar i aplikimit do të njihet në fitimet e mbartura më 1 janar 2018 dhe që pasqyrat krahasuese nuk do të ndryshohen. Për rrjedhojë, Shoqëria do të aplikojë SNRF 15 në mënyrë prapavepruese vetëm për kontratat që nuk janë përfunduar në datën e aplikimit fillestar (pra 1 janar 2018).

Gjatë vitit 2017, Shoqëria bëri një vlerësim paraprak të SNRF 15, i cili në datën në të cilën keto pasqyra financiare janë aprovuar, nuk ishte përfunduar akoma. Meqënëse Shoqëria kryen transaksionet e shitjes në para, përgjithësisht nuk ka terma kreditimi dhe nuk ka kontrata afatgjata të ardhurash, ajo nuk pret që standardi i ri të ketë ndikim të konsiderueshëm në raportimin financiar.

SNRF 9 Instrumentet Financiare

Në korrik 2014, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK), publikoi versionin final të SNRF 9 Instrumentat Financiare, i cili zëvendësoi SNK 39 Instrumentat Financiare: Njohja dhe Matja si dhe të gjitha versionet e mëparshme të SNRF 9. SNRF 9 përmbledh të treja aspektet e projektit të kontabilizimit të instrumentave financiarë: klasifikimi dhe matja, zhvlerësimi dhe kontabilizimi mbrojtës. SNRF 9 është efektiv për periudhat që fillojnë në ose pas 1 janar 2018, ku aplikimi i më hershëm është i lejuar. Me përjashtim të kontabilitetit mbrojtës, aplikimi në periudhat e mëparshme është i kërkuar, por informacioni krahasues nuk është i detyrueshëm. Për kontabilitetin mbrojtës, kërkesat përgjithësisht kërkojnë aplikim në periudhat në vijim, më një numër të përcaktuar përjashtimesh.

4. STANDARDE TË PUBLIKUARA POR ENDE TË PAZBATUARA (VAZHDIM)

SNRF 9 Instrumentet Financiare (vashzim)

Shoqëria planifikon të aplikojë standartin e ri në datën efektive të përcaktuar dhe nuk do të rideklarojë informacionin krahasues. Gjatë vitit 2017, Shoqëria ka bërë një vlerësim të ndikimit të tre aspekteve të SNRF 9. Ky vlerësim bazohet në informacionin aktual dhe mund të jetë subjekt i ndryshimeve që vijnë nga informacioni i mëtejshëm i asyrtueshëm që do të jetë në dispozicion të Shoqërisë në vitin 2018 kur Shoqëria të aplikojë SNRF 9.

Në përgjithësi, Shoqëria nuk pret ndonjë ndikim domethënës në pasqyrën e pozicionit financiar dhe në kapital. Shoqëria nuk pret ndonjë ndryshim në humbjet nga zhverësimi. Për më tepër, Shoqëria, për shkak të llojeve të limituara të instrumentave financiarë, nuk pret ndryshime në klasifikimin e instrumentave financiarë (p.sh. llogari të arkëtueshme).

Klasifikimi dhe matja

Shoqëria nuk pret ndonjë ndikim të rëndësishëm në bilancin apo kapitalin e saj nga aplikimi i klasifikimit dhe matjes së kërkuar nga SNRF 9 meqenese nuk zoteron vlera të medha instrumentash financiare. Ajo pret të vazhdojë matjen me kosto të amortizuara të të gjitha aktiveve financiare aktuale të prezantuara nën zërin “aktivet afatshkurtra”.

Llogaritë e arkëtueshme mbahen për të mbledhur flukse hyrëse kontraktuale dhe pritet që të sjellin flukse të parasë që përfaqësojnë vetëm pagesa kontraktuale dhe interesa. Bazuar në marrëveshjet kontraktuale me klientët e saj, Shoqëria ka analizuar karakteristikat e flukseve kontraktuale të këtyre instrumentave dhe ka arritur në përfundimin që ato plotësojnë kushtet për matjen me kosto të amortizuara sipas SNRF 9. Kështu që, nuk kërkohet riklasifikimi i këtyre instrumentave.

Zhvlerësimi

SNRF 9 kërkon që Shoqëria të regjistrojë humbjet e pritshme të kredisë të të gjitha letrave me vlerë, kredive dhe llogarive të arkëtueshme, në baza 12 mujore ose të jetëgjatësisë. Shoqëria do të aplikojë metodën e thjeshtuar dhe do të regjistrojë humbjet e pritshme të jetëgjatësisë të të gjitha llogarive të arkëtueshme. Shoqëria ka përcaktuar se, për shkak të praktikave aktuale të termave të pagesës, nuk pret që këto ndryshime të kenë një ndikim të rëndësishëm.

SNRF 16 Qiratë

SNRF 16 është lëshuar në janar 2016 dhe zëvendëson SNK 17 Qiradhënie, KIRFN 4 Përcaktimi nëse një Marrëveshje përmban një qira, SIC-15 Nxitjet e Qirasë Operative dhe KIS-27 Vlerësimi i Substancës së Transaksioneve që përfshijnë Formën Ligjore të Qirasë. SNRF 16 përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të qirasë dhe kërkon që qiramarrësit të japin llogari për të gjitha qiratë sipas një modeli të vetëm në bilanc, ngjashëm me kontabilitetin për qiratë financiare sipas SNK 17. Kontabiliteti i qiradhënësit sipas SNRF 16 është në thelb i pandryshuar nga kontabilizimi i sotëm sipas SNK 17. SNRF 16 gjithashtu kërkon që qiramarrësi dhe qiradhënësi të bëjnë më shumë informacion shpjegues se sa sipas SNK 17. SNRF 16 është efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019. Aplikimi i hershëm lejohet, por jo para se një entitet të që aplikimi i këtij standarti të ri të ketë ndikim në pasqyrat e saj financiare, duke qenë se ajo nuk ka transaksione materiale si qeramarrëse.

SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve

Në Maj 2017, BSNK publikoi SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve (SNRF 17), një standard i ri kontabël i përgjithshëm për kontratat e sigurimeve. Sapo të hyjë në fuqi, SNRF 17 do të zëvendësojë SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve (SNRF 4).

SNRF 17 zbatohet për të gjitha llojet e kontratave të sigurimit (dmth jetë, jo-jetë, sigurimi i drejtpërdrejtë dhe risigurimi) pavarësisht llojit të subjekteve që i lëshojnë ato, si dhe garancive të caktuara dhe instrumenteve financiare me karakteristika të pjesëmarrjes së lirë. SNRF 17 është efektive për periudhat e raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021, me shifra krahasuese të nevojshme. Aplikimi i hershëm është i lejuar, me kusht që entiteti të zbatojë gjithashtu SNRF 9 dhe SNRF 15 në ose para datës së zbatimit të parë të SNRF 17. Ky standard nuk është i zbatueshëm për Shoqërinë.

Spar ALBANIA Sh.p.k.**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***5. TË ARDHURA NGA SHITJA E MALLRAVE**

Të ardhurat nga shitjet të grupuara sipas departamenteve në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse paraqiten si më poshte:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Produkte ushqimore të paketuara, detergjente dhe të tjera	3.110.192	2.589.741
Produkte ushqimore të freskëta	671.518	580.479
Zbritje nga shitjet	(35.841)	(10.633)
Totali i produkteve të konsumueshme	4.034.772	3.159.587
Produkte joushqimore	210.954	174.446
Produkte elektronike dhe elektrike	33.956	29.357
Tekstile	43.893	39.047
Totali i produkteve jo të konsumueshme	288.802	242.850
Të ardhura nga shitja pronave te paluejtshme	1.218.649	-
Totali	5.253.421	3.402.438

6. TË ARDHURA TË TJERA

Të ardhura të tjera në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse paraqiten si më poshte:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Tarifat e hyrjes	29.696	18.020
Shërbime për furnitorët e produkteve	9.651	60.924
Të ardhura të tjera	30.424	14.756
Totali	69.770	93.700

Të ardhurat nga shërbimet e dhëna furnitorëve të produkteve, janë të lidhura me aktivitetet e promovimit të ofruara nga Shoqëria. Promovime të tilla përfshijnë marketingun e produkteve në treg dhe fletëpalosje të lëshuara nga Shoqëria.

7. KOSTO E MALLRAVE TË SHITURA

Kosto të mallrave të shitur të grupuara sipas departamenteve në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse paraqiten si më poshte:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2016
Produkte të konsumueshme	3.193.731	2.767.391
Produkte jo të konsumueshme	220.521	199.481
Kosto e pasurive te paluejtshme të shitura	498.128	-
Totali	3.912.379	2.966.873

8. SHPENZIME PËR MATERIALE

Shpenzime për materiale në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse paraqiten si më poshte:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2016
Materiale për riparime dhe mirëmbajtje	23.290	19.285
Karburant	3.711	3.531
Totali	27.001	22.816

Spar Albania Sh.p.k.**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***9. SHPENZIME PËR SHËRBIME**

Shpenzime për shërbime në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse paraqiten si më poshte:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2016
Qira operative	292.514	323.437
Shpenzime reklama dhe marketing	91.243	55.070
Shpenzime energjie, ngrohje, uje	79.070	94.599
Tarifa bankare dhe komisione	23.879	12.763
Shpenzime sigurie	18.755	24.369
Tarifa franchise, licenca dhe mirembajtje	16.831	12.849
Të tjera	12.710	6.177
Shpenzime për konsulecë kontabel dhe audit	12.628	1.661
Shpenzime noteriale dhe ligjore	6.337	1.219
Shpenzime pastrimi	5.493	6.259
Materiale (qese plastike)	3.820	17.862
Shpenzime telekomunikacioni	2.451	2.816
Shërbime rekrutimi	2.337	506
Totali	568.070	559.621

Tarifa Franchise është regjistruar bazuar në kontratën Franchise të përdorimit të emrit. Materialet kanë të bëjnë me ambalazhet me logon e Shoqërisë.

10. SHPENZIME PËR PERSONELIN

Shpenzime për personelin në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse paraqiten si më poshte:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2016
Pagat e punonjësve	174.733	174.733
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	28.147	27.677
Totali	202.411	202.411

11. (HUMBJA)/ FITIMI NETO NGA KURSET E KEMBIMIT

Fitimi/ (humbje) neto nga kurset e këmbimit në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse paraqiten si më poshte:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga konvertimi	37.369	112.691
Humbje nga konvertimi	(50.477)	(69.381)
(Humbja)/ fitimi neto nga kurset e këmbimit	(13.108)	43.309

Spar ALBANIA Sh.p.k.**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***12. SHPENZIME TË TJERA**

Shpenzime të tjera në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse paraqiten si më poshtë:

	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2016
Provizion	11.091	8.157
Taksa dhe tarifa	8.221	8.359
Gjoha dhe penalitete	6.137	6.025
Shpenzime të tjera për personelin	4.037	9.188
Shpenzime përfaqësimi	2.325	-
Udhëtime biznesi	2.038	2.329
Kancelari	1.395	1.076
Të tjera	807	3.377
Sigurime të tjera	424	598
Humbje nga shitja e asetëve	201	1.039
Totali	36.676	40.417

Shoqëria ka njohur një provizion për diferenca të lindura gjatë numerimit të inventarit si dhe për mallra të dëmtuara në fund te vitit.

13. SHPENZIME FINANCIARE

Shpenzime financiare në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse paraqiten si më poshtë:

	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shpenzime interesi për overdrafte	11.240	10.759
Shpenzime interesi për kredi me afat	7.432	13.816
Të ardhura nga interesi për huadhenie	(14.312)	-
Totali	4.360	24.576

Shoqëria ka një linjë Overdrafti në Veneto Bank në vlerën 280 milion lekë për të cilën paguan 4.0% interes vjetor dhe një kredi të marrë në First Investment Bank për të cilën interesi është 4.14%. Ndërkohë që ka një hua të dhënë me një interes vjetor të përfitueshëm prej 4.2%.

14. TATIMI MBI FITIMIN

Rakordimi i shpenzimeve të tatimit të llogaritur me normën e tatimit ligjor mbi fitimin nga aktivitetet operative para tatimit mbi të ardhurat me shpenzimet e tatim fitimit për llogaritur me normën efektive të tatimit mbi fitimin për Shoqërinë më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqiten si më poshtë:

	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2016
Humbja para tatimit	510.879	(305.939)
<i>Shtesat:</i>		
Provizione	11.091	4.639
Shpenzimet e pazbritshme për efekt tatimor	42.132	5.554
Amortizimi për efekt tatimor	(13.502)	(9.962)
Shpenzimet e pazbritshme për efekt tatimor	39.721	252
Fitimi para tatimit	550.600	(305.687)
Tatimi mbi fitimin me 15%	-	-
Humbje tatimore e mbartur nga viti	(690.635)	(384.948)
Humbje tatimore per tu mbartur	(140.035)	(690.635)

(Të lërat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

14. TATIMI MBI FITIMIN (VAZHDIM)

Në bazë të parashikimeve, Shoqëria nuk ka përllogaritur një aktiv tatimor të shtyrë në lidhje me humbjet e mbartura.

Aktivet tatimore të shtyra që lidhen me humbjet e mbartura dhe diferencat e përkohshme të zbritshme njihen nëse është e mundur që të përdoren (kompensohen) kundrejt fitimit të ardhshëm tatimor ose kundrejt diferencave të përkohshme ekzistuese. Diferencat e përkohshme të zbritshme kundrejt aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale lidhen me normat e ndryshme të amortizimit të lejueshme për qëllime të përllogaritjes së tatimit mbi fitimin.

Spar ALBANIA Sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

15. AKTIVET TË TRUPËZUARA, NETO

Aktivët atëgjatë të trupëzuara në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

Kosto	Makinëri dhe pajisje	Mjete transporti	Pajisje dhe rafte	Pajisje dhe mobilje zyre	Aktive të tjera	Totali
Më 1 janar 2016	214.105	1.419	4.451	15.002	3.030	238.007
Shtesa	11.766	2.064	17.704	1.883	9.095	42.512
Pakësime	7.418	-	-	140	556	8.115
Më 31 dhjetor 2016	218.453	3.483	22.155	16.746	11.569	272.405
Shtesa	40.947	-	11.223	5.475	7.251	64.896
Pakësime	694	-	126	61	53	934
Më 31 dhjetor 2017	258.706	3.483	33.251	22.159	18.767	336.367
Amortizimi						
Amortizimi me 1 janar 2016	11.603	115	907	951	308	13.884
Amortizimi vitit	27.510	397	4.089	1.810	2.992	36.798
Pakësime	996	-	-	14	185	1.165
Më 31 dhjetor 2016	38.146	513	4.997	2.747	3.115	49.517
Amortizimi vitit	24.110	402	5.319	3.966	6.250	40.047
Më 31 dhjetor 2017	62.256	914	10.316	6.713	9.364	89.564
Vlera kontabël neto						
Më 31 dhjetor 2016	180.306	2.970	17.158	13.999	8.454	222.888
Më 31 dhjetor 2017	196.450	2.569	22.935	15.447	9.403	246.803

Spar ALBANIA Sh.p.k.**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***16. AKTIVET TË PATRUPËZUARA, NETO**

Aktivitet afatgjatë të patrupëzuara në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	Programe kompjuterike	Totali
Kosto		
Më 1 janar 2016	5.493	5.493
Shtesa	-	-
Më 31 dhjetor 2016	5.493	5.493
Shtesa	1.095	1.095
Më 31 dhjetor 2017	4.398	4.398
Amortizimi		
Më 31 dhjetor 2015	415	415
Amortizimi vitit	1.333	1.333
Më 31 dhjetor 2016	1.748	1.748
Amortizimi vitit	1.259	1.259
Më 31 dhjetor 2017	3.008	3.008
Vlera kontabël		
Më 31 dhjetor 2016	3.745	3.745
Më 31 dhjetor 2017	1.390	1.390

17. INVENSTIME MBI SHOQËRITË E KONTROLLUARA

Gjatë vitit 2017, Shoqëria investoi në aksione për themelimin e Shoqërisë së re Spar Elbasan sh.p.k me një vlerë investimi prej 17.220.150 lekë, që përbën 51% të aksioneve të Shoqërisë. Aktiviteti kryesor i kësaj Shoqërie është shitje me shumicë dhe pakicë të mallrave dhe artikujve të ndryshëm industriale, ushqimore, blegtorale dhe bujqësore, pajisjeve freskuese dhe alkalike, duhan, cigare, të tjera. Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në qytetin e Elbasanit.

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2016
Investime në shoqëritë e kontrolluara	17.220	-
Totali	17.220	-

18. HUADHËNIE

Huadhëniet në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 përfaqesojnë huatë e dhëna nga RFZ Building ndaj Mane TCI dhe të tjerë para përrhithjes:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
<i>Huadhëniet</i>		
Mane TCI	322.082	322.082
Të tjera	22.736	6.095
Totali	344.818	328.177
<i>Huatë sipas maturimit</i>		
Afatshkurtër (deri në një vit)	344.818	6.095
Afatgjatë (mbi një vit)	-	322.082
Totali	344.818	328.177

Spar Albania Sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

22. KAPITALI AKSIONAR

Me 31 dhjetor 2017 kapitali i regjistruar dhe plotesisht i paguar është 600 milion lekë dhe përbëhet nga një aksion i zakonshëm me vlerë nominale 600.502.914 lekë.

23. HUAMARRJE

Huamarrjet në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
<i>Principal</i>		
Kontribut nga Balfin	-	180.000
Kredi Bankare	170.301	160.763
Overdrafte Bankare	297.743	115.506
Totali	468.044	456.270
<i>Interesa të përllogaritura</i>		
Kredi Bankare	587	13.816
Overdafte Bankare	1.929	10.759
Totali	2.516	24.576
<i>Huate sipas maturimit</i>		
Afatshkurtër (deri në një vit)	357.652	351.695
Afatgjatë (mbi një vit)	110.392	104.574
Totali	468.044	456.270

Kontribut nga Ortaku Balfin shpk - Gjatë vitit 2016 Ortaku i Shoqërisë ka kontribuar me mjete monetare për të mbështetur nevojat për pagesa të Shoqërisë. Këto mjete monetare janë bërë në periudha të ndryshme gjatë vitit 2016 dhe nuk mbajnë interes. Gjatë vitit 2017, këto mjete monetare i janë kthyer pas Ortakut por njëkohësisht Shoqëria ka marr përsëri fonde nga Ortaku për të mbështetur nevojat e saj.

Kredi nga First Investment Bank - Më 16 shtator 2015, Shoqëria ka nënshkruar një kredi afatmesme (4 vit maturimi) me First Investment Bank, për një shumë totale prej 1.500 mijë euro (ekuivalenti 205.920 mijë lekë). Huaja ka një normë interesi prej EURIBOR 2M plus 6.2% në vit.

Pagesat e interesit janë të pagueshme në fund të cdo muaji kalendarik duke u bazuar në numrin faktik të ditëve të kaluara dhe duke supozuar një vit me 360 ditë. Principali është i pagueshëm në këste të barabartë mujore.

Gjatë vitit 2017, huaja është rfinansuar për vlerën prej 2.000 euro më interes vjetor prej 4.14%

Overdraft - Më 27 maj 2015, Veneto Bank sh.a dhe Shoqëria lidhën një marrëveshje për kredi për kapital qarkullues deri në shumën 280.000 mijë lekë. Norma e aplikueshme e interesit është EURIBOR 3M plus 3.00% në vit për shumat e përdorura në lekë dhe pagesat e interesit janë të pagueshme në fund të cdo tremujori kalendarik duke u bazuar në numrin faktik të ditëve të kaluara dhe duke supozuar një vit me 360 ditë. Pagesa e plotë e principalit është e pagueshme në ditën e fundit të afatit të kredisë. Kredia është e rinovueshme me konsensusin e të dy palëve.

(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

24. LLOGARI TË PAGUESHME DHE DETYRIME TË TJERA

Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve të mallrave	897.518	708.473
Parapagime nga klientët pas përthithjes së RFZ	594.939	719.492
Detyrime ndaj furnitorëve	99.541	74.361
Të ardhura të shtyra	32.489	269.179
Detyrime të përlllogaritura	8.850	13.907
Detyrime të pagueshme për sigurime	4.158	3.742
Detyrime për tatim page	669	543
Detyrime për tatim në burim	415	796
Detyrime për tatim fitimin	-	6.688
Totali	<u>1.638.579</u>	<u>1.797.181</u>

Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera nuk mbartin interes dhe në përgjithësi janë të pagueshme brenda harkut kohor 60-180 ditë. Detyrimet ndaj furnitorëve të mallrave shlyhen në bazë të faturimit.

Parapagime nga klientët përfaqëson arkëtime në avancë për porositë e apartamenteve/ dyqaneve etj. si rrjedhojë e përthithjes së RFZ Building.

Të ardhura të shtyra përfaqëson kontratat e shitjes me rezerve të kompanisë së perthithur RFZ Building.

25. PALËT E LIDHURA

Shoqëria ka marrëdhënie me Shoqëritë e tjera, për shkak të transaksioneve me Shoqërinë mëmë dhe simotra të saj.

Tabelat e mëposhtme tregojnë shumën totale të transaksioneve që janë kryer me palët e lidhura në vitin e caktuar financiar.

a) Llogari të arkëtueshme nga/ të pagueshme për palët e lidhura

Llogari të arkëtueshme dhe të pagueshme që rrjedhin nga transaksionet e përmendura më sipër janë paraqitur më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>		<u>31 dhjetor 2016</u>	
	Të arkëtueshme nga palët e lidhura	Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	Të arkëtueshm e nga palët e lidhura	Të pagueshme ndaj palëve të lidhura
Hua nga shoqëria mëmë	-	-	-	180.000
Hua për shoqëri të tjera të grupit	322.082	-	322.082	-
Të tjera nga shoqëria mëmë	822.933	42.900	16.183	859
Të tjera nga shoqëri të grupit	97.628	64.062	107.094	94.437
Totali	<u>1.242.642</u>	<u>106.962</u>	<u>445.359</u>	<u>275.297</u>

(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

25. PALËT E LIDHURA (VAZHDIM)

b) Blerja dhe shitja e mallrave dhe shërbime

Blerja dhe shitja e mallrave dhe shërbimeve që rrjedhin nga transaksionet e përmendura më sipër janë paraqitur më poshtë:

	31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
	Shitje palëve të lidhura	Blerje palëve të lidhura	Shitje palëve të lidhura	Blerje palëve të lidhura
Shoqëria mëmë	749	34.583	1.595	3.007
Shoqëri të tjera të grupi	73.753	204.034	29.549	263.981
Totali	74.502	238.616	31.144	266.987

26. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA

Angazhime

Pagesat minimale të ardhshme të qirasë sipas kontratave të qirasë operative janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Jo me vonë se një vit	224.641	258.479
Nga 1 vit deri në 5 vjet	556.097	650.263
Më vonë se 5 vjet	-	-
Totali	780.738	908.742

Shoqëria ka hyre në angazhime qiraje për të gjitha supermarketet me një kohëzgjatje maksimale prej pesë vjetësh.

Detyrime të mundshme tatimore

Legjislacioni tatimor dhe doganor shqiptar i cili ishte në fuqi apo që konsiderohet si i tillë në fund të periudhës raportuese është subjekt i interpretimeve të ndryshme kur aplikohet në transaksionet dhe aktivitetet e Shoqërisë. Rrjedhimisht, pozicioni tatimor mund të kundërshtohet nga autoritetet përkatëse. Periudhat fiskale mbeten të hapura për shqyrtim nga organet tatimore shqiptare për pesë vite kalendarike nga viti i shqyrtimit. Në rrethana të caktuara kontrolllet mund të mbulojnë periudha më të gjata.

Duke qënë se legjislacioni tatimor shqiptar nuk mund të japë udhëzime definitive në fusha të caktuara, herë pas here, Shoqëria adopton interpretime mbi këto fusha. Ndërkohë që drejtimi vlerëson se pozicioni tatimor dhe interpretimet që Shoqëria ka kryer janë të qëndrueshme, ekziston rreziku që të jetë e nevojshme përdorimi i burimeve në rast se këto pozicione tatimore dhe interpretime vihen në diskutim nga autoritetet përkatëse.

Ndikimi i këtyre mundësive nuk mund të vlerësohet me besueshmëri, megjithatë, ajo mund të jetë e rëndësishme për pozicionin financiar dhe/ose veprimtarinë e përgjithshme të Shoqërisë.

Çështje ligjore

Shoqërisa nuk ka pretendime ligjore të ngritura nga pale të treta apo punonjës të saj.

27. OBJEKTIVAT DHE POLITIKAT E MENAXHIMIT TË RISKUT FINANCIAR

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të ndryshme në lidhje me instrumentet e veta financiare. Rreziqet kryesore të mundshme janë rreziku i tregut, rreziku i kredisë dhe rreziku i likuiditetit.

27.1. Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që vlera e drejtë e flukseve të ardhshme monetare nga instrumentet financiare do të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve në emimet e tregut. Cmimet e tregut përfshijnë tre lloje rreziqesh: rreziku i normës së interesit, rreziku i kursit të këmbimit dhe rreziku i cmimeve të tjera, si për shembull rreziku i ndryshimit të cmimeve të letrave me vlerë të tregtuara në bursë. Instrumentet financiare të ndikuara nga rreziku i tregut përfshijnë kredite dhe llogaritë e pagueshme.

(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

27. OBJEKTIVAT DHE POLITIKAT E MENAXHIMIT TË RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**27.1. Rreziku i tregut (vazhdim)**

Analizat e ndjeshmërisë në seksionet e mëposhtme lidhen me pozicionin më 31 dhjetor 2017. Analizat e ndjeshmërisë janë përgatitur sipas supozimit se shuma e borxhit dhe pjesa e instrumenteve financiare në monedhë të huaj janë konstante. Analiza përjashton ndikimin e ndryshimeve të variablave të tregut të provigjoneve.

Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit është rreziku se vlera e drejtë e flukseve të ardhshme monetare nga instrumentet financiare do të ndryshojë për shkak të ndryshimeve në normën e interesit të tregut. Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të ndryshimit të normave të interesit të tregut lidhet fillimisht me detyrimet afatshkurtra të Shoqërisë me norma interesi të ndryshueshme. Duke qënë se këto kredi janë kryesisht afatshkurtra, Shoqëria nuk e konsideron rrezikun të rëndësishëm dhe nuk ka adoptuar ende ndonjë politikë për ta zvogëluar atë. Tabela e mëposhtme tregon ndjeshmerinë ndaj ndryshimeve të mundshme dhe të arsyeshme të normës së interesit, me të gjitha variablat e tjera të mbajtura konstante, në fitimin e Shoqërisë para tatimit (përmes ndikimit të normave të ndryshueshme të kredisë).

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Rritje prej 100 pike bazë	(4.680)	(2.722)
Në % të fitimit para tatimit	(0.92%)	0.89%

Rreziku i kursit të këmbimit

Rreziku i kursit të këmbimit është rreziku që vlera e drejtë e flukseve të ardhshme monetare nga instrumentet financiare do të ndryshojë për shkak të ndryshimeve në kursin e këmbimit. Shoqëria hyn në transaksione me valute të huaj lidhur me aktivitetin e saj financiar dhe operativ. Shoqëria nuk përdor ndonjë instrument financiar specifik për t'u mbrojtur nga rreziku. Pjesa më e madhe e transaksioneve të Shoqërisë janë në EUR dhe LEK dhe meqenëse kursi i këmbimit Lek/Euro është i qëndrueshëm, rreziku i kursit të këmbimit konsiderohet të jetë i ulët.

31 dhjetor 2017	EUR	USD	LEK	Totali
Aktive financiare				
Mjete monetare	21.909	13.403	196.262	218.170
Hua afatshkurtra	6.095	-	338.722	344.818
Llogari të arkëtueshme	44.879	-	695.348	740.227
	72.883	13.403	1.230.332	1.303.215
Detyrime financiare				
Furnitorë dhe detyrime të tjera	604.437	-	1.027.413	1.631.850
Hua	320.085	-	147.959	468.044
	924.522	-	1.175.372	2.099.894
Hendeku i monedhës 31 dhjetor 2017	(851.639)	13.403	54.960	(769.679)

31 dhjetor 2016

	EUR	USD	LEK	Totali
Aktive financiare				
Mjete monetare	21.011	-	141.619	162.631
Hua afatshkurtra	6.095	-	-	6.095
Llogari të arkëtueshme	272.571	-	523.995	796.566
	299.678	-	665.614	965.292
Detyrime financiare				
Furnitorë dhe detyrime të tjera	372.526	79	1.424.575	1.797.181
Hua	161.196	-	295.074	456.270
	533.722	79	1.719.649	2.253.450
Hendeku i monedhës 31 dhjetor 2016	(234.044)	(79)	(1.054.035)	(1.288.158)

Spar Albania Sh.p.k.**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Vlerat në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***27.2. Rreziku i kreditimit**

Rreziku i kreditimit lindë në rastin kur arrin të përmbushë detyrimet në rastin e një instrumenti financiar. Shoqëria nuk është e ekspozuar kundrejt një rreziku të rëndësishëm të kreditit duke qënë se ka relativisht nivel të ulët të llogarive të arkëtueshme nga klientët. Për shkak të karakteristikave të biznesit të saj, Shoqëria shet mallra të një numri të madh konsumatorësh ku cmimi i shitjes paguhet në shumicën e rasteve me para në dorë ose me kartë debiti/krediti. Transaksionet monetare kryhen nëpërmjet institucioneve që kanë vleresim të mirë kreditor.

Ekspozimi maksimal bruto paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Mjete monetare dhe ekuivalentët e saj (pa përfshirë paratë në dorë)	134.066	114.467
Llogari të arkëtueshme dhe të drejta të tjera, bruto	740.227	811.824
Huadhënie	344.818	328.177
Totali	<u>1.219.111</u>	<u>1.254.468</u>

27.3. Rreziku i likuiditetit

Menaxhimi efektiv i likuiditetit të Shoqërisë lidhet me sigurimin e financimit të kapitalit qarkullues përmes përdorimit të kredive me interes nga palët e lidhura dhe bankat. Drejtuesit e Shoqërisë vazhdimisht monitorojnë afatin dhe kryerjen e pagesave në kohë duke mbajtur të përditësuar informacionin mbi flukset e nevojshme të parasë dhe pagesat e ardhshme. Paratë e disponueshme investohen në depozita afatshkurtra me norma interesi me të mira në bankat vendase.

Më 31 dhjetor 2017, struktura e maturitetit të detyrimeve financiare të Shoqërisë ndaj pagesave kontraktuale të paskontuara paraqitet si më poshtë;

	<u>< 3 muaj</u>	<u>3 - 12 muaj</u>	<u>1 - 5 vjet</u>	<u>Totali</u>
31 dhjetor 2017				
Huatë me interes	-	357.652	110.392	468.044
Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera	-	1.631.850	-	1.631.850
Totali	-	<u>1.989.502</u>	<u>110.392</u>	<u>2.099.894</u>
	<u>< 3 muaj</u>	<u>3 - 12 muaj</u>	<u>1 - 5 vjet</u>	<u>Totali</u>
31 dhjetor 2016				
Huatë me interes	-	167.589	104.574	272.163
Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera	-	1.797.181	-	1.797.181
Totali	-	<u>1.964.770</u>	<u>104.574</u>	<u>2.069.344</u>

28. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit që do të kërkonte rregullime ose shënime të tjera shpjeguese në keto pasqyra financiare.